



Drejtuar: Operatorit ekonomik "K. Turja" shpk
Adresa: Bubq, Budull, pranë Urës së Gjoles, Durrës.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: "Procedurë e Hapur" **"Rehabilitim i Sheshit Qeha"**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: **"Rehabilitim i Sheshit Qeha"**.

Fondi limit: 17,244,429.99 (shtatëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzetë e katër mijë e katërqind e njëzetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB-së Nr. 84, datë 29.12.2016 për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017".

Kohëzgjatja e kontratës: 8 (tetë) javë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 20.03.2017, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 8 datë 27.02.2017.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "K. Turja" shpk

NUIS K81314014A

Vlera e ofertës = **12,421,116** (dymbëdhjetë milion e katërqind e njëzetë e një mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik "Bahas" shpk

NUIS J61827083D

Vlera e ofertës = **13,270,278** (trembëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Edonil Konstruksion” shpk
NUIS K11519006K

Vlera e ofertës = **14,413,535** (katërmbëdhjetë milion e katërqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Avduli” shpk
NUIS J66703306O

Vlera e ofertës = **15,468,518** (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Liqeni VII” sha
NUIS K01730502W

Vlera e ofertës = **15,969,107.70** (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatë pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk
NUIS K51712017A

Vlera e ofertës = **16,383,677** (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Operatori ekonomik “Bahas” shpk

NUIS J61827083D

- Operatori ekonomik “Bahas” shpk nuk plotëson pikën “13” të Kapacitetit teknik : *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)”* **pasi nuk ka deklaruar dhe paraqitur dokumentacion për mjetin e kërkuar Autobitumatricen ku të identifikohet targa, numri i lejes por ka deklaruar mjetin Bitumatrice.**

2. Operatori ekonomik “Edonil Konstruksion” shpk

NUIS K11519006K

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se në librezën e punës të mjekut të përgjithshëm nuk figuron punësimi i tij pranë shoqërisë “Edonil Konstruksion” shpk,

çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.

- Bilanci i vitit 2015 i paraqitur nga Operatori ekonomik “Edonil Konstruksion” shpk është dokument fotokopje, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit ku përcaktohet se: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”*
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik, konstatoi se Inxhinieri i Mjedisit nuk figuron në listpagesat e shoqërisë “Edonil Konstruksion” shpk për 3 (tre) muajt e fundit pasi mungon për muajin Dhjetor 2016, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- KVO konstatoi se Operatori ekonomik “Edonil Konstruksion” shpk nuk ka deklaruar sipas Shtojcës 9 se disponon 1 (një) Autobot Uji si dhe 1 (një) Autobitumatriçe , çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 13.
- Gjithashtu shoqëria “Edonil Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se disponon 1 (një) makineri për vijëzim me bojë bikomponente, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 13.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Edonil Konstruksion” shpk, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik “Avduli” shpk

NUIS J667033060

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për punonjës të përcaktuar konstatoi se nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Avduli” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) kamiona vetshkarkues përkatësisht me targa VL 0835 D dhe AA 258 EV. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruara, konstatoi se mjeti me targa VL 0835 D ka kapacitet mbajtës 6.9 ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 13 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) Kamiona Vetshkarkues minimum 10 ton.”*
- Shoqëria “Avduli” shpk ka deklaruar sipas Shtojcës 9 se disponon 1 (një) Autobot Uji me targa AA 035 JY. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues, konstatoi se mjeti i deklaruar si më lart rezultoi të jetë Autobot uji i montuar, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 13 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”*.

- Shoqëria “Avduli” shpk nuk ka paraqitur foto për mjetet: Asfaltoshtruese; Rrul me vibrim; Matrapik; Vibrator betoni si dhe Makineri vijëzimi me bojë bikomponente, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 13, gërma “d”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Avduli” shpk, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Liqeni VII” sha

NUIS K01730502W

- Operatori ekonomik “Liqeni VII” sha nuk ka paraqitur Shtojcën 11, “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore”, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, pika 1.
- Operatori ekonomik “Liqeni VII” sha nuk ka paraqitur Shtojcën 5, “Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve Teknike”, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “a”.
- Shoqëria “Liqeni VII” sha nuk ka paraqitur Shtojcën 7, “Deklaratë mbi konfliktin e interesave”, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “b”.
- Shoqëria “Liqeni VII” sha nuk ka paraqitur Shtojcën 9, “Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve”, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “d”.
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Deklaratën për Drejtuesin Teknik të punimeve, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Dëshmia e kualifikimit për punonjës in elektrikist nuk është e vlefshme, pasi ka skaduar më datë 20.10.2016, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.

5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk

NUIS K51712017A

- Operatori ekonomik “**Kacdedja**” shpk nuk plotëson pikën “13” të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)” pasi në shtojcën 9 ka deklaruar si Autobitumatrice mjetin me targë TR 0344L por nga verifikimi i dokumentacion rezulton se ky është një mjet i montuar: kamion i certifikuar për transport mallrash +pompë (bitumatrice).*
- Operatori ekonomik “**Kacdedja**” shpk nuk plotëson pikën “d” të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për*

secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit” pasi për mjetin e deklaruar si Autobitumatrice me targë TR 0344L nuk ka paraqitur foto.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “K. Turja” shpk**, me adresë: **Bubq, Budull, pranë Urës së Gjoles, Durrës**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **12,421,116** (dymbëdhjetë milion e katërqind e njëzetë e një mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 04.04.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

